



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1528/6 prot.

Datë 26.06.2024

V E N D I M
Nr. 758/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2024, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “*Blerje pajisje kompjuterike*”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë, Rruga: “Fortuzi 66/1”, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Bulqizë
Adresa: Lagjja “Minatori”.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.06.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II.2. Në datën 11.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK, me nr. 1528/2024 prot., datë 11.06.2024, dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4191, datë 10.06.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3 Në datën 11.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK, me nr. 1528/1 prot., datë 11.06.2024, dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4193, datë 10.06.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, e njëjtë në objekt; Nr. REF apo vlerë si ajo e ankesës Nr 1528/2024 datë 11.06.2024.

II.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor nr. 3143 prot., datë 13.6.2024, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, protokolluar me tonën me nr. 1528/3, datë 18.06.2024. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur mospranimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BluePrint Technologies” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar, “1- *Heqjen e kerkeses 2.2.2 ne paragrafin 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit 2022, 2023, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet. Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet. Procedura objekt ankimimit eshte procedure ‘E hapur e Thjeshtuar’. Per keto procedura, LPP dhe VKM per RPP parashikon se Kriteret ekonomike financiare duhet te jene te thjeshtuara, dhe keto te fundit provohen me paraqitjen e vertetimit te xhiros per 3 vitet e fundit. (neni 55, pika 4, i VKM 285, date 19.05.2021). Per sa me siper, kerkojme qe kjo kerkese te hiqet*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2, ka parashikuar si më poshtë:

2.2.2. *Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit 2022, 2023, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet. Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.*

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021, “Për prokurimin publik” parashikohet se: “*Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik*”.

III.1.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, 162/2021, “Për prokurimin publik,” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”*.

III.1.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, 162/2021, “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.

III.1.5 Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare . 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. 4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit . 5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës*

III.1.6. Në nenin 55, “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.[...]”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP vëren, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, **Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit 2022, 2023.** Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “procedurë e hapur e thjeshtuar”, legjislacioni parashikon, që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin e kërkesës së dorëzimit të kopjeve të bilanceve të certifikuara, që plotësimi i këtyre kërkesave të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BluePrint Technologies” SHPK “2- Saktesimin e pikes 22.vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta Ligji 16/2024, neni 27 percakton: Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët. Gjithashtu, ne kete ligj, percaktohet se deri ne daljen e akteve nenligjore (VKM si dhe DST) ne zbatim te ligjit , AK mund te vijojne te aplikojne aktet e vjetra nenligjore. Duke qene se ne piken 22 , ju i referoheni ligjit te vjeter (AK kerkon shpjegime per oferten anomalisht te ulet dhe nuk e skualifikon ate automatikisht), ju lutemi te saktesoni nese per kete procedure do te zbatohet ligji i vjeter, sic dhe pasqyrohet ne DST, apo do te aplikohet ligji i ri, ku ofertat anomalisht te ulta do te skualifikohen automatikisht.”

III.2.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BluePrint Technologies” SHPK, “ Ne piken 2.4.2 ndër të tjera kërkohet: b) OE duhet të deklarojë se emri i kompanisë të tonerit, është i stampuar (jo etiketë e ngjitur) dhe i njëjtë, në paketim në pjesën plastike dhe në pullën e sigurisë. c) Për të vërtetuar origjinalitetin e tonerave do të bëhet kontrolli nëpërmjet barkodit në internet.

2 kërkesat më sipër nuk janë në përputhje me LPP dhe VKM për RPP..., kërkojmë që pika b dhe c më sipër të hiqen nga kriteret e kualifikimit si të pambështetura në ligj”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.3. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi kriterin në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në këtë kuadër objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se projekti apo specifikimi teknik/ apo kriteri është në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi kërkesën e sipërpërmendur. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të 13 tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit”*, në kthim - përgjigjen me nr. 3143 prot., datë 13.06.2024, protokolluar me tonën nr. 1528/3, datë 18.06.2024, ka sqaruar se *“ 2. Në lidhje me saktësimin e pikes 22, Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetikore dhe ofertave anomalisht të ulëta. Mbeshtetur në ligjin 162/2020 "Për Prokurimin Publik", me ndryshimet e fundit nepermjet ligjit nr. 16/2024, në nenin 27, përcaktohet "Në nenin 93 pas pikes 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: "5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijte e lartë monetare, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një oferte, e cila është konstatuar anomalisht e ulët", pra autoriteti kontraktor, ka sqaruar për paqartësitë tija, lidhur me kërkesat për sqarim. Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në sistemin e prokurimit elektronik, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, gjithashtu dhe sqarimet të publikohen
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

